

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT / INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente.....	14
Aneks	14

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Çmimeve
1.3. Personi i kontaktit	Hazbie Bunguri
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Çmimeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Kodi ZIP 1017, Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	hbunguri@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	12.01.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	12.01.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	12.01.2022
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga njësitë ekonomike familjare për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të njësive ekonomike familjare. Indeksi është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve, të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synon për konsum final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.</p> <p>Përdoret si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane, duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.</p>

<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>IÇK/IHÇK llogariten sipas Klasifikimit të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (COICOP). Grupet kryesore të shpenzimeve janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 01. Ushqime, pije joalkoolike dhe duhan 02. Pije alkoolike dhe duhan 03. Veshje dhe këpucë 04. Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji elektrike 05. Mobilie, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje 06. Shëndetësi 07. Transport 08. Komunikim 09. Arsimit dhe kulturë 10. Shërbim arsimor 11. Hotele, kafene dhe restorante 12. Mallra dhe shërbime të tjera
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>IÇK mbulon shpenzimet për mallra dhe shërbime të njësive ekonomike familjare (NjEF) shqiptare. IHÇK mbulon shpenzimet për mallra dhe shërbime të njësive ekonomike familjare shqiptare dhe turistëve të huaj.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Shporta është tërësia e mallrave dhe shpenzimeve të përzgjedhura për matjen e ndryshimit të çmimeve. Çmimi i referohet çmimit aktual, që konsumatori paguan për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, përfshi taksat dhe subvencionet.</p> <p>Çmimet e vitit bazë janë çmimet referuese të llogaritjes së indeksit. Çmimi relativ është raporti i çmimit të produktit në periudhën korrente me çmimin e produktit në Dhjetor të vitit të mëparshëm.</p> <p>Njësia ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo, të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.</p> <p>IÇK/IHÇK mat ndryshimin e një shporte përfaqësuese mallrash dhe shërbimesh, të konsumuara në Shqipëri dhe janë llogaritur bazuar në metodologjinë e harmonizuar dhe një numër i caktuar rregulloresh. IÇK/IHÇK janë indekse të tipit Laspeyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna mujore: <ul style="list-style-type: none"> ○ Indeks 2020=100, ○ Ndryshimet vjetore, ○ Ndryshimet mujore, ○ Ndryshimet mestare vjetore. • Të dhëna vjetore: <ul style="list-style-type: none"> ○ Indeksi mesatar dhe përqindja e ndryshimit, <p>Peshat e produkteve në nivel 4 shifror.</p>

3.5. Njësia statistikore	<p>Çdo indeks (IÇK) apo ndryshim çmimi i publikuar i referohet “konsumit final të familjeve individuale” në Shqipëri.</p> <p>Çdo indeks (IHÇK) apo ndryshim çmimi i publikuar i referohet “shpenzimeve monetare të konsumit final” në Shqipëri. Njësia statistikore është NjEF-ja që kryen shpenzimet e konsumit në Shqipëri.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata statistikore e synuar në IÇK janë shpenzimet monetare të konsumit final të NjEF-ve shqiptare rezidente në territorin e Shqipërisë. IÇK krahason të gjitha blerjet e bëra nga familjet shqiptare brenda dhe jashtë territorit të vendit, vetëm nga personat rezident. IÇK përjashton interesat dhe kartat e kreditit, duke i konsideruar ato si kosto financiare, jo si shpenzime konsumatore.</p> <p>Popullata statistikore e synuar në IHÇK janë “shpenzimet monetare të konsumit final” të NjEF-ve shqiptare dhe të huaja në territorin e Shqipërisë. Ky përkufizim ndjek konceptin e Llogarive Kombëtare të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). IHÇK krahason të gjitha blerjet nga familjet shqiptare dhe jo shqiptare (rezidente dhe jo rezidente) brenda territorit të vendit. IHÇK mbulon çmimet e paguara për mallra dhe shërbime në shkëmbime financiare. Çmimet që maten janë ato që faktikisht paguhen nga konsumatori. IHÇK përjashton interesat dhe kartat e kreditit, duke i konsideruar ato si kosto financiare dhe jo si shpenzime konsumatore.</p>
3.7. Zona e referencës	Shqipëria ka 12 qarqe. Për qëllim të llogaritjes së IÇK/IHÇK-së janë përdorur 11 qarqe, qarku i Kukësit është përfaqësuar nga qarku Dibër.
3.8. Mbulimi në kohë	IÇK për Shqipërinë ekziston në seri kohore që nga viti 1993. IHÇK për Shqipërinë ekziston në seri kohore që nga viti 2016.
3.9. Periudha bazë	Periudha referuese (bazë) për IÇK/IHÇK është muaji Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100).
4. Njësia matëse	<p>Treguesit që përdoren janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Indeksi (që është raporti i çmimeve të një shporte mallrash dhe shërbimesh në një vit të dhënë me çmimet e vitit bazë dhe është i shprehur në përqindje. • IÇK/IHÇK mund të imagjinohet si një madhësi e konsumit mesatar, që do të shpenzohet në një vit të dhënë, për të blerë disa mallra dhe shërbime bazë që do të kishin kushtuar 100 lekë (njësi monetare) në vitin bazë. • Përqindja e ndryshimit me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm (ndryshimi vjetor).
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës së të dhënave për IÇK/IHÇK është muaji. Ky raport i referohet vitit 2021.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Indekset e Çmimeve të Konsumit IÇK/IHÇK llogariten bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e KE Nr 2494/95, • Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare; • Programin e Statistikave Zyrtare, 2017-2021.

	<p>Indekset e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK-të) janë tregues të inflacionit të harmonizuar, llogaritur mbështetur në Rregulloren e KE Nr.2494/95 të datës 23 Tetor 1995 dhe bazuar në një tërësi aktesh ligjore për hartimin e metodologjisë së harmonizuar për llogaritjen e IHÇK-së. Rregullorja përfshin rregulla specifike për llogaritjen e indekseve të harmonizuara për produkte të veçanta. Të gjitha rregulloret si dhe rekomandimet mund ti gjeni në linkun: Legjislacioni</p> <p>Indekset e Çmimeve të Konsumit (IÇK-të) pavarësisht nga ndryshimet metodologjike të përdorura nga vendet, janë të njohur si matës zyrtar të inflacionit dhe përdoren kryesisht për nevoja të brendshme. IÇK në Shqipëri llogaritet duke përdorur dhe zbatuar një numër të konsiderueshëm rregulloresh të IHÇK-së, duke siguruar kështu një përputhshmëri të lartë midis indekseve.</p>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	IÇK dërgohet në EUROSTAT çdo vit. IHÇK dërgohet në EUROSTAT çdo muaj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njërive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njërive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor</p>

	<p>verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Të dhënat e publikuara të IÇK/IHÇK janë të shprehura në indeks ose ndryshim në përqindje dhe nuk konsiderohen si konfidenciale.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e web të INSTAT. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e IÇK/IHÇK janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Website – online release, • Kërkesat e shkruara, (me postë ose email) • Publikimet • Seksioni kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Rezultatet e IÇK/IHÇK publikohen në baza mujore.
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp për IÇK/IHÇK përmban informacion në lidhje me ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve. Formatin e njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar, ai është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i IÇK/IHÇK publikohet online në faqen Web të INSTAT.

10.2. Publikime	Publikimet e IÇK/IHÇK gjenden të botuara në faqen e internetit të INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> • Çmimet • Librat
10.3. Baza e të dhënave on-line	Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e IÇK/IHÇK nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun më poshtë: Kërko të dhëna
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një përshkrim i shkurtër metodologjik i llogaritjes së Indeksi Çmimesh të Konsumit është publikuar në faqen e internetit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Çmimesh të Konsumit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e IÇK/IHÇK për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	IÇK/IHÇK janë matësit më të mirë të inflacionit në vend (IÇK) dhe për krahasimin e inflacionit midis vendeve të Evropës (IHÇK). Sektori kontrollon çmimet çdo muaj. Nëse vërehet ndonjë çmim që ka lëvizje të madhe krahasuar me muajin e mëparshëm komunikohet me anketuesin. Nëse marrim një shpjegim justifikues për këtë ndryshim, çmimi përfshihet në llogaritje. Përndryshe anketuesi duhet të verifikojë përsëri çmimin e mbledhur në terren. Në formatin e raportimit të çmimesh është vendosur një algoritëm kontrolli që sinjalizon çmimet me ndryshim mujor + ose – 25%. Gjithashtu është vendosur edhe kodi shpjegues për tipet e ndryshme të ndryshimeve të mëdha të çmimesh.

12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e IÇK/IHÇK ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike, • Universitetet, • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare, • Bizneset, • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Botimi i rezultateve të IÇK dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish.</p> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e IÇK/IHÇK-së si input në punën e tyre. Këto janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare, • Sektori i Statistikave Afatshkurtra.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me “Indeksi i Çmimeve të Konsumit” dhe për vitin 2021 janë rreth 56,463 klikime.</p> <p>Gjatë 2021 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e statistikave të IÇK është vlerësuar me 3.62 (72.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Shkalla e plotshmërisë të të dhënave, për Indeksin e Çmimeve të Konsumit 2021 është 100 %. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë indikatorët që kërkohen nga EUROSTAT bazuar në rregulloren “Commission Regulation (EC) 1749/99, 23 Korrik 1999”.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Saktësia e përgjithshme e IÇK/IHÇK-së konsiderohet të jetë e lartë veçanërisht në saktësinë metodologjike të burimit të peshave dhe çmimeve dhe llogaritjes në përputhje me Rregulloren Evropiane. Zgjedhja e produkteve të shportës është bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve (ABF). Mallrat dhe shërbimet e përzgjedhura janë përfaqësuese për konsumatorin ato kanë një përqindje të konsiderueshme ndaj totalit të konsumit dhe reflektojnë më mire ndryshimin e çmimeve të produkteve. Çmimet mblidhen në tipe të ndryshme dyqanesh, markete, supermarkete, tregje të hapura në 11 qarqe. Çmimet mblidhen kryesisht nëpërmjet intervistës direkt, me telefon, me e-mail dhe nëpërmjet internetit. Për llogaritjen e peshave për IÇK-në janë përdorur shpenzimet e NjEF-së rezidente shqiptare, ndërsa për IHÇK-në përdoren shpenzimet e NjEF-së rezidente dhe jo rezidente në Shqipëri.</p>

13.2. Gabim i kampionimit	Nuk është e aplikueshme për aktivitetin statistikor, pasi IÇK/IHÇK janë të bazuara në kampione jo-probabilitare. Për të reduktuar gabimet, mbliidhen sa më shumë çmime.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë pikat e shitjes që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk gjejnë produktin. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi për IÇK/IHÇK është 0 %. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për IÇK/IHÇK është 0 %.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Indeksi Çmimeve të Konsumit” janë publikuar në faqen web të INSTAT 12 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 12 ditë). Periudha referuese e rezultateve të “Indeksi Çmimeve të Konsumit” është 31 Dhjetor 2021.</p> <table border="1" data-bbox="539 831 1002 936"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>1/12/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>12</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	1/12/2022	Afatet kohore	12		
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e publikimit	1/12/2022								
Afatet kohore	12								
14.2. Përpikmëria	<p>Në fund të çdo viti, INSTAT publikon Kalendarin e Publikimeve me data fikse për vitin e ardhshëm. Bazuar në këtë kalendar publikimi i IÇK ka qenë i përpiktë në kohë, në 100% të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="539 1122 1002 1261"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>1/12/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>1/12/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	1/12/2022	Data e publikimit	1/12/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	1/12/2022								
Data e publikimit	1/12/2022								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>IÇK dhe IHÇK bazohen në një metodologji të harmonizuar, dhe si të tillë ato reflektojnë lëvizjet e çmimeve dhe dallimet në konsumin e popullsisë së vendit. Të dhënat e IÇK-së janë plotësisht të krahasueshme midis qarqeve, pasi metoda e llogaritjes së këtij aktiviteti statistikor, në të gjitha fazat e tij është i njëjtë për të gjithë qarqet. E njëjta metodologji dhe përpunim të dhënash janë përdorur për të dhënat nga të gjithë qarqet. Të gjithë qarqet janë mbuluar me të njëjtën shpërndarje. Gjithashtu inflacioni i përgjithshëm i vendit varet nga madhësia relative (shpenzimet gjithsej) të çdo qarku. Për të krahasuar inflacionin me vendet e Bashkimit Evropian përdoren të dhënat e ofruara nga IHÇK.</p>								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>IÇK dhe IHÇK janë plotësisht të krahasueshëm në kohë. Ka pasur disa përmirësime në metodologji me qëllim përmirësimin në besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e IÇK/IHÇK-së. Indekset e mëparshme janë rillogaritur me bazën e re, duke siguruar kështu krahasueshmërinë në kohë të indeksit.</p> <p>Indeksi i Çmimeve të Konsumit sipas grupeve kryesore, referuar databazës</p>								

	<p>statistikore është i krahasueshëm duke filluar nga viti 2007 deri në 2021, duke na garantuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 15 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=15$).</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>IÇK dhe IHÇK janë dy matës të ndarë të inflacionit. Ndryshimi kryesor ndërmjet dy indekseve është se IHÇK merr në konsideratë çdo njësi monetare (lekë) të shpenzuar në territorin e Shqipërisë, pra blerjet e bëra nga shqiptarët dhe jo shqiptarët, ndërsa IÇK merr në konsideratë çdo njësi monetare (lekë) të shpenzuar nga shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndryshime të tjera janë:</p> <p>IÇK:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë llogaritur bazuar në ABF, • Peshat janë të shprehura në për 100, • Monitorohet nga INSTAT. <p>IHÇK:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë llogaritur bazuar në Llogaritë Kombëtare, • Peshat janë të shprehura në për 1000, • Monitorohet nga Eurostat, • Renta e imputuar nuk është element i shportës.
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Prodhimi i indekseve IÇK/IHÇK është realizuar në përputhje me një procedurë të mirëpërcaktuar, e cila kontrollon koherencën e brendshme të të dhënave të mbledhura.</p>
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personat që punojnë për IÇK/IHÇK janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Staf i Sektorit të Çmimeve në zyrat qendrore: 2 punonjës, • Staf në zyrat rajonale: 10 punonjës, • Anketues: 12 punonjës
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të IÇK/IHÇK bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në vitet 2002, 2003 dhe 2004, seritë e IÇK-së janë rinovuar për shkak të ndryshimit metodologjik të trajtimit të artikullit “Renta e imputuar”. Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e “IÇK/IHÇK” për vitin 2021, subjekt i këtij raporti.</p>

18. Përpunimi statistikor

18.1. Burimi i të dhënave	<p>Zgjedhja e produkteve është bërë nga INSTAT, ndërsa përzgjedhja e njësive të shitjes (tregtare) dhe produkteve për çdo njësi është në bashkëpunim me zyrat rajonale të statistikave. Përzgjedhja e produkteve të shportës është bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF).</p> <p>Burimi kryesor i llogaritjes së peshave është Anketa e Buxhetit të Familjes për IÇK dhe Llogaritë Kombëtare për IHÇK.</p> <p>Në vitin 2021 shporta për IÇK përmban 331 artikuj ndërsa për IHÇK shporta përmban 329 artikuj. Çdo muaj afërsisht mblidhen rreth 23,124 çmime individuale në rreth 3,500 njësi tregtare.</p> <p>Numri i artikujve për çdo muaj shpërndahet si më poshtë (IÇK 331 artikuj dhe IHÇK 329 artikuj):</p> <ol style="list-style-type: none">01. Ushqime, pije joalkoolike dhe duhan: 10102. Pije alkoolike dhe duhan: 603. Veshje dhe këpucë: 4004. Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji elektrike: 13 (12)05. Mobilie, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje: 4206. Shëndetësi: 1207. Transport: 2008. Komunikim: 809. Arsim dhe kulturë: 36 (35)10. Shërbim arsimor: 711. Hotele, kafene dhe restorante: 1912. Mallra dhe shërbime të tjera: 27 <p>Numri i çmimeve të mbledhura për çdo produkt është mesatarisht rreth 23,124 i ndarë në grupet kryesore si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">01. Ushqime, pije joalkoolike dhe duhan: 7,95002. Pije alkoolike dhe duhan: 44703. Veshje dhe këpucë: 2,74204. Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji elektrike: 63805. Mobilie, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje: 2,78806. Shëndetësi: 75507. Transport: 1,30308. Komunikim: 41709. Arsim dhe kulturë: 2,14810. Shërbim arsimor: 30511. Hotele, kafene dhe restorante: 1,49512. Mallra dhe shërbime të tjera: 2,136
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Çmimet për shumicën e mallrave dhe shërbimeve mblidhen një herë në muaj në një datë të përcaktuar, nga data 10-25 e çdo muaji.</p> <p>Çmimet për disa produkte, kryesisht fruta dhe zarzavate me sezonalitet të madh mblidhen edhe 2-3 herë në muaj dhe çmimi mesatar përdoret për llogaritjen e indeksit.</p>

	<p>Çmimet për biletat e udhëtimit me avion dhe traget mblidhen 2 muaj më përpara, në një datë të caktuar të muajit.</p> <p>Çmimet për disa produkte të tjera si tarifatat për universitete, çmimi i librit shkollor, tarifatat e qëndrimit në konvikte mblidhen një herë në vit.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Zgjedhja e dyqaneve</p> <p>Çmimet mblidhen në njësitë tregtare më përfaqësuese në vend. Në kushtet e mungesës së një regjistri real të njërive tregtare me karakteristikat e domosdoshme, përzgjedhja e njërive është realizuar nga specialistët e zyrave rajonale të statistikave në bashkëpunim me anketuesin e qarkut bazuar në instruksionet e përgatitura nga zyra qendrore e statistikës. Pikat e shitjeve me pakicë, nga të cilat janë mbledhur çmimet, janë përzgjedhur për të përfaqësuar situatën reale të tregut dhe të shërbimeve ekzistuese.</p> <p>Përzgjedhja bazohet në tre kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Popullariteti me blerës, • Vlera e shitjeve. • Disponueshmëria e mallrave dhe shërbimeve të përfshira në shportën e IÇK-së. <p>Kriteret e përzgjedhjes janë objekt përditësimi.</p> <p>Një herë në vit, zakonisht në Nëntor dhe Dhjetor përditësohet kampioni i njërive tregtare. Njësitë e përzgjedhura janë të tipeve të ndryshme si markete, supermarketet, dyqane të specializuara, restorante, kafene, hotele, etj, që gjenden në qendër apo në periferi të qytetit.</p> <p>Përzgjedhja e produkteve dhe specifikimeve teknike</p> <p>Produktet përfaqësuese janë zgjedhur në fund të çdo viti, bazuar në gjykimin e stafit të zyrave rajonale të statistikave të rretheve në bashkëpunim me anketuesit e çmimeve të cilët gjithashtu përcaktojnë specifikimet e produkteve. Përzgjedhja e produkteve dhe përcaktimi i specifikimeve mbikqyret nga stafi qëndror. Specifikimet e produktit janë diskutuar dhe rënë dakord në takimet me anketuesit e çmimeve, të cilët më parë mbledhin informacion në qarkun e tyre. Këto produkte janë zgjedhur në bazë të informacioneve të marra nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat e ABF-së, • Statistikat e Tregtisë me Pakicë, • Sugjerimet e anketuesve të çmimeve, në konsultim edhe me produkt listat e vrojtimit për matjen e barazisë së fuqisë blerëse, • Informacion nga shitësit e dyqaneve, • Burime të tjera. <p>Specifikimi i produkteve përfshin detaje në lidhje me sasinë, markën, materialin, etj. Specifikimi varet nga natyra e produktit dhe në specifikim përfshihen karakteristikat kryesore të produktit të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përcaktimin e çmimit.</p>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Të gjitha çmimet e mbledhura kontrollohen nga anketuesit e çmimeve para se të hidhen në kompjuter, më pas kontrollohen edhe njëherë nga specialisti i</p>

	<p>zyrës rajonale përpara se të dërgohen në zyrën qendrore të statistikës (INSTAT).</p> <p>Në formatin e raportimit të çmimeve ka një sinjal automatik për çmimet jo korrekte të gjetura gjatë procesit të hedhjes së të dhënave. Nëse ka dyshime rreth besueshmërisë së çmimeve të raportuara për një ose disa produkte nga stafi i zyrës qendrore, atëherë kontaktohet me anketuesit e çmimeve, nëpërmjet specialistit të zyrës rajonale.</p> <p>Çdo rast problematik trajtohet më vete dhe të gjitha modifikimet bëhen bazuar në informacionin e marrë nga anketuesit.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Peshat për IÇK</p> <p>Shpenzimet e konsumit monetare finale të familjeve shqiptare janë përdorur për llogaritjen e peshave që përdoren për llogaritjet e IÇK-së. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet finale është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK-ja në vitin t llogaritet në bazë të shpenzimeve të vitit, $t-1$. Burim shtesë i përdorur janë të dhënat nga Llogaritë kombëtare, konkretisht për rentën e imputuar, pijet alkoolike dhe duhanin. Peshat janë shprehur si pjesë e shpenzimeve gjithsej të mallrave dhe shërbimeve brenda shportës së indeksit. Peshat përditësohen çdo vit bazuar në të dhënat e ABF-së dhe burime të tjera shtesë.</p> <p>Peshat për IHÇK</p> <p>Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me Rregulloren e KE Nr. 1114/2010 dhe rregulloren e KE Nr. 1688/98. Peshat reflektojnë strukturën e shpenzimeve të konsumit monetar final të familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë. Llogaritë kombëtare janë burimi kryesor i të dhënave për llogaritjen e peshave të IHÇK. IHÇK në vitin t llogaritet me peshat e vitit $t-2$.</p> <p>Llogaritja e indeksit në nivel të detajuar</p> <p>Indeksi elementar llogaritet duke përdorur mesataren gjeometrike të pa peshuar të çmimeve të mbledhura për çdo produkt.</p> <p>Llogaritja e indeksit në nivel të agreguar dhe indeksit gjithsej Indekset e agreguara dhe indeksi gjithsej llogariten duke përdorur formulën e Laspeyres. Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë. Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK-në e Shqipërisë.</p> <p>Trajtimi i artikujve që mungojnë dhe zëvendësimi</p> <p>Kur një artikull jo-sezonal mungon përkohësisht çmimi i regjistruar mbahet për një deri në dy muaj, por njëkohësisht gjejmë një artikull të ri që do ta zëvendësojë. Kur bindemi se artikulli jo-sezonal është zhdukur përgjithmonë, në muajin e tretë e zëvendësojmë me produktin e gjetur. Ndonjëherë zëvendësimi i produktit shoqërohet me rregullime cilësore.</p> <p>Përfshirja në listë e mallrave dhe shërbimeve të reja</p> <p>Në muajin Dhjetor të çdo viti bëhet përditësimi i shportës së mallrave dhe shërbimeve duke përfshirë produktet e reja që janë konsideruar të rëndësishme</p>

	<p>gjatë vitit.</p> <p>Trajtimi i çmimeve me ulje: Çmimet me ulje përfshihen në indeks për aq kohë sa ekzistojnë për të gjithë konsumatorët. Trajtimi i çmimeve për artikujt sezonale: Produktet sezonale në IÇK/IHÇK trajtohen në përputhje me rregulloren e BE Nr.330/2009. Ata trajtohen me pesha fikse gjatë gjithë vitit, që do të thotë se indeksi i vitit për produktet sezonale është llogaritur me pesha fikse. Çmimet për produktet sezonale kryesisht fruta dhe perime gjatë periudhës që dalin nga qarkullimi imputohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në muajin e parë, jashtë sezonit çmimi mbahet i njëjtë me çmimin mesatar të periudhës së mëparshme të sezonit. • Nga muaji i dytë, çmimi vlerësohet me çmimin e mëparshëm shumëzuar me ndryshimin mesatar relative të çmimeve të produkteve që ekzistojnë.
18.6. Rregullimi	<p>Rregullimet për diferencat e cilësisë: Kur llogariten IÇK dhe IHÇK, e rëndësishme është marrja e çmimeve për produkte që nuk kanë ndryshim në cilësi, sepse ndryshimi i çmimit duhet të reflektojë vetëm ndryshimin e pastër të çmimit, jo ndryshimin që vjen për shkak të ndryshimit të cilësisë. Për rregullimet e cilësisë përdoren metodat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullimi i sasisë: Vlera e ndryshimit të sasisë së paketimit si pjesë e çmimit të mbledhur konvertohet në çmimin për sasinë e kërkuar, • Mbivendosja vjetore: Për shumë produkte, në fund të vitit përditësohet kampioni i njësisë tregtare. Muaji Dhjetor përdoret si muaj lidhës i indeksit dhe për këtë arsye gjatë këtij muaji çmimet mblidhen dy herë, për kampionin e vjetër dhe kampionin e ri. Ndryshimet cilësore ndërmjet dy kampioneve eliminohen duke përdorur metodën e “mbivendosjes” të quajtur “mbivendosje vjetore”, • Krahasimi direkt: Anketuesit janë udhëzuar të mbledhin çmimet për të njëjtin varietet gjatë gjithë vitit dhe nëse varieteti del nga qarkullimi përkohësisht ato duhet të zgjedhin një artikull tjetër për zëvendësim sa më shumë të ngjashëm në cilësi. Në këtë rast aplikohet metoda e krahasimit direkt sepse diferenca e cilësisë është e papërfillshme. • Metoda e gjykimit: Vlera e rregulluar e cilësisë ndërmjet dy produkteve bazohet në informacionin shtesë raportuar nga anketuesit. <p>Rregullimet e cilësisë bëhen nga stafi në zyrën qendrore. Në nivel rajonal, anketuesit nuk mund të bëjnë rregullime, ato vetëm janë të instruktuar të raportojnë në zyrën qendrore të statistikës, për të gjitha rastet me ndryshim të konsiderueshëm cilësie të produktit zëvendësues (disa nga arsyet kryesore).</p> <p>Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara.</p>
19. Komente	
Aneks	